



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE  
PËR VITIN 2020**

**Prishtinë, korrik 2021**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

## Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve  
Adresa: Sheshi Nëna Terezë, Prishtinë, Prishtinë, Republika e Kosovës

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

Opinionin dhe konkluzionin jepen vetëm për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, pa përfshirë Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës, për të cilat kryejmë auditime të veçanta si dhe përgatisim raporte individuale, përfshirë edhe opinionet e auditimit.

### Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Rregullorja nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare, kërkon që komisioni për inventarizim ta bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive. Komisioni kishte përgatitur raportin me vonesë dhe përveç kësaj nuk kishte arritur të bënte krahasimin apo harmonizimin në mes këtyre dy dokumenteve. Vlera e pasurive sipas PFV-ve (këtu përfshihen pasuritë mbi 1,000€, nën 1,000€ dhe stoqet ishte 9,371,020€).

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

- 1 Në muajin shkurt të vitit 2020, në kuadër të Ministrisë së Financave është bërë fuzionimi i ish programeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke u emëruar si Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ky fuzionim ka vazhduar deri në muajin gusht 2020 ku ka pasur kthim të gjendjes fillestare nga Ministria e Financave dhe Transfereve në Ministrinë e Financave. Të gjitha shpenzimet e krijuara në periudhën sa programet e ish MPMS ishin në kuadër të MF janë transferuar dhe raportuar në Ministrinë e linjës/MPMS, konform kërkesave të Ligjit të Buxhetit nr.07/L-014.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

## Çështje tjetër

- 1 Me vendimin e Qeverisë së Kosovës me nr.01/58 të datës 24.07.2018 është vendosur që të kompensohen dëmet e shkaktuara nga breshëri në Komunitet e Kosovës. Me këtë Vendim është autorizuar Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) që të krijoj një fond të veçantë për vitin 2019, për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë. Megjithatë, MFPT-ja nuk e kishte krijuar fondin për vitin 2019 ashtu siç është kërkuar me Vendimin e Qeverisë. Ai ishte krijuar me ligjin për ndarjet buxhetore të vitit 2020 në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Vonesa e krijimit të fondit kishte rezultuar me kërkesa nga qytetarët që kompensimin për dëmet e shkaktuara nga breshëri t'i kërkojnë përmes përmbauesve privat. Sidoqoftë përveç Vendimit të Qeverisë, ne nuk kemi parë ndonjë zotim final nga asnjë instancë qeveritare për realizimin e pagesave individuale dhe as nuk ishin përcaktuar afate për realizimin e tyre. Rrjedhimisht, MFPT-ja kishte kërkuar prapësimin e vendimeve të përmbauesve, ku disa nga këto kërkesa ishin refuzuar nga Gjykata Themelore dhe vendimet për përmbauesve të tyre kishin marrë formë të prerë. Pagesat për këto raste ishin bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndonëse i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Vlera totale e këtyre pagesave për vitin 2020 ishte 378,624€.
- Përkundër realizimit të pagesave, MFPT-ja ka vazhduar me procedura për prapësim të vendimeve të Gjykatës Themelore në shkallë të dytë të Gjykatës së Apelit dhe deri sa ne ishim në auditim, 13 nga 22 raste ishin kthyer në rigjykim në shkallën e parë.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me keq klasifikimin e shpenzimeve, mos harmonizimin e regjistrit të pasurive me atë të inventarizimit, mos përdorimi i e-pasurisë, mos harmonizimin e të hyrave me Thesarin dhe zbatimin e ulët të rekomandimeve të dhëna nga AB. Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të përmirësonte kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike<sup>4</sup>



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël

#### Gjetja

Sipas Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare neni 19, pika 4.3, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare duhet të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

MFPT kishte formuar Komisionin për Inventarizimin e pasurisë me datën 14.10.2020. Mirëpo Komisioni nuk kishte arritur ta përfundojë dhe ta përgatitë raportin mbi inventarizimin e pasurisë në afatin e paraparë kohor. Ky raport ishte përgatitur me datën 03.03.2021. Më tutje, Komisioni për Inventarizim nuk kishte bërë krahasimin/harmonizimin ndërmjet gjendjes së regjistrave të pasurisë dhe gjendjes së dalë nga procesi i inventarizimit. Vlera totale e pasurive sipas PFV, duke përfshirë pasuritë mbi 1,000€, nën 1,000€ dhe stoqet ishte 9,371,020€.

Sipas kryesueses së komisionit, komisioni kishte hasur në vështirësi në kryerjen e punëve në afatet e parapara kohore për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 (puna me staf esencial në zyre).

#### Ndikimi

Mos harmonizimi i regjistrave kontabël me gjendjen e dalëse të inventarizimit, rritë rrezikun që pasuritë të keqpërdoren, humbin apo të tjetërsohen, si dhe pasuria e organizatës e prezantuar në PFV të jetë e mbivlerësuar apo nënvlerësuar.

#### Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që proceset e menaxhimit të pasurisë janë transparente dhe bëhen në përputhje të plotë me rregullën për menaxhimin e pasurive, duke harmonizuar gjendjen e pasurive me gjendjen e dalë nga inventarizimi.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Çështjet për pasqyrat financiare

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

#### Çështja A2 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas nenit 3 të Rregullës Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo financiare, pasuri kapitale nënkupton të gjitha pasuritë jo financiare që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, vlerë financiare mbi 1,000€ si dhe pronësia dhe kontrolli janë të organizatës.

Pagesa për "Furnizim me licencë për mirëmbajtjen e infrastrukturës së serverëve ekzistuese për periudhë 1 vjeçare " në vlerë prej 30,762€ (PC kompjuter për nevoja të Thesarit 35 copë në vlerë prej 28,140€ dhe furnizimi me 13 Laptops në vlerë prej 8,151€), pagesa është bërë nga kategoria jo adekuate e investimeve kapitale, përkatësisht nga kodi ekonomik 31610 furnizim me pajisje të IT-së. Për nga lloji i kontratës dhe shpenzimit, kjo i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, pasuri jo kapitale.

Gabimet më sipër kanë ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të buxhetit nga ana e Thesarit dhe kujdesit të pamjaftueshëm të departamentit të buxhetit për të parandaluar ndarjet buxhetore në kodet e gabuara të shpenzimeve.

**Ndikimi** Pagesat e kryera nga kategoria joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në nënvlerësimin e disa llogarive dhe mbivlerësimin e llogarive tjera, që për efekt kanë paraqitjen e pa saktë apo keq pohimin e gjendjes së llogarive.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ri destinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Të hyrat

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, përfshirë Doganën e Kosovës (DK) dhe Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), për vitin 2020 ka realizuar të hyra neto prej 1,487,059,242€, ndërkaq vetëm MFPT ka realizuar 493,043€. Këto të hyra kanë të bëjnë me gjobat ndaj institucioneve financiare dhe gjoba tjera, të hyrat nga licencimi i aktiviteteve individuale dhe të lira.

### Çështja A3 - Mos barazimi mujor i të hyrave në Thesar

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare nr.03/2010 për të Hyrat, neni 13- pika 1, pas çdo mbyllje të periudhës mujore, OB është e obliguar që t'a bëjë barazimin e të hyrave në Thesar.

Në kuadër të MFPT-së, funksionon Njësia e Inteligjencës Financiare si agjenci. Të hyrat e realizuara nga NjIF (gjoba ndaj institucioneve financiare), menaxhohen nga zyrtari i të hyrave të kësaj të fundit, dhe të njëjtat regjistrohen në llogarinë e MFPT-së. Për të hyrat e realizuara për vitin 2020 në vlerë prej 320,000€, NjIF nuk kishte bërë barazimet mujore me Thesarin. Barazimi kishte filluar të bëhet nga muaji nëntor, pas rekomandimit tonë gjatë intervistave të zhvilluara në fazën e planifikimit.

Sipas zyrtarëve, kjo ka ndodhur si mungesë e informacionit për kërkesat e rregullores nga ana e zyrtarit përkatës.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i të hyrave në baza të rregullta mujore me regjistrat kontabël të Thesarit pamundëson identifikimin e mos barazimeve të mundshme, dhe njëkohësisht e vë në dyshim saktësinë e informatave për të dhënat e raportuara.

**Rekomandimi A3** Ministri duhet të siguroj se pas çdo mbyllje të periudhës mujore, zyrtarët përgjegjës bëjnë barazimin e të hyrave me Thesarin, të realizuara nga secili departament në kuadër të MF-së.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.2.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitë) në vitin 2020 ishte 7,498,886€, prej tyre ishin shpenzuar 6,013,562€ apo 80%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtje të teknologjisë informative, furnizim me pajisje tjera, furnizime për zyrë, karburant për vetura zyrtare dhe për ngrohje qendrore, sigurimi i ndërtesave tjera dhe qiraja për ndërtesa.

#### Çështja C1 - Avanset e pambyllura në SIMFK nga vitet paraprake

##### Gjetja

Sipas UA nr. 2004/07 për udhëtime zyrtare, neni 8, avanset për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Sipas PFV-ve dhe të dhënave të ofruara nga zyrtarët përgjegjës të MFPT-së, avanset e pambyllura deri në fund të vitit 2020 ishin 11,494€, të cilat kishin mbetur të hapura nga vitet e kaluara. MFPT gjatë vitit 2019 kishte formuar grupin për mbylljen e këtyre avanseve në bashkëpunim me Thesarin, mirëpo ky proces ende nuk ka përfunduar në tërësi. Vlen të theksohet se deri në kohën sa ishim në auditim, bilanci i tyre kishte zbritur dhe vlera e tyre ishte 6,889€.

Kjo kishte ndodhur si mungesë e koordinimit dhe angazhimit më dinamik të zyrtarëve përgjegjës, për reduktim të mëtejshëm të kësaj shume.

##### Ndikimi

Mos mbyllja e avanseve në sistem - regjistra kontabël, ka ndikuar që llogaritë e avanseve të vazhdojnë të mbesin aktive dhe të barten nga viti në vit.

##### Rekomandimi C1

Ministri duhet të vazhdojë bashkëpunimin e mëtejshëm me Thesarin, me qëllim të eliminimit total të këtyre avanseve të hapura, si dhe të siguroj në të ardhmen mos përsëritjen e situatave të njëjta.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 8,233,327€, pasurive jokapitale është 852,544€, si dhe e stoqeve 285,149€.

### Çështja A4 - Mos përdorimi i sistemit E-Pasuria

#### Gjetja

Rregullorja nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare neni 6-pika 3, thekson se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pasurinë jo financiare në vlerë prej 7,350€ dhe stoqet në vlerë prej 6,406€, nuk e kishte menaxhuar përmes sistemit E-pasuria. Po ashtu nuk kishte ndonjë regjistër apo evidencë tjetër për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë. Të dhënat apo informatat në lidhje me pasurinë jo kapitale në 1,000€, dhe stoqeve i kishte siguruar nga komisioni për inventarizim pas numërimit dhe identifikimit të pasurisë në fund vit.

Sipas zyrtarit për menaxhimin e pasurisë edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme drejtuar kompanisë përgjegjëse për funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, kompania kishte treguar neglizhencë, pasi që nuk kishin arritur të funksionalizojnë sistemin e-pasuria.

#### Ndikimi

Mos menaxhimi i pasurive jo kapitale nën 1,000€ përmes sistemit e-pasuria si dhe mungesa e një regjistri të veçantë të këtyre pasurive, vështirësojnë menaxhimin efektiv, vë në dyshim saktësinë e informatave dhe rrezikon humbjen a tyre.

#### Rekomandimi A4

Ministri duhet të vazhdojë të bëjë kërkesë ndaj kompanisë përgjegjëse për sistemin e-pasuria dhe njëkohësisht të monitoroj nga afër funksionalizimin e këtij sistemi, në mënyrë që të sigurohet se pasuritë jo kapitale dhe stoqet regjistrohen dhe menaxhohen përmes këtij sistemi.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) është e organizuar në dy divizione, atë për auditime në MFPT si dhe divizionin për auditime jashtë MFPT-së, në entitetet që nuk kanë të themeluara Njësinë e AB-së. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve. NjAB kishte hartuar Planin Strategjik 2020-2022 dhe Planin Vjetor të Punës ku janë përfshirë njësitë dhe fushat që paraqesin ndjeshmëri më të lartë, e të cilat ishin planifikuar të auditohen. Për vitin 2020 ishin planifikuar 19 auditime, ku 15 prej tyre ishin relizuar, ndërsa pjesa tjetër është në proces, kjo për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid-19. Në kuadër të MFPT-së është i themeluar Komiteti i Auditimit, ku mbahen takime të rregullta tre mujore si dhe regjistrohen minutat e këtyre takimeve. Në këto takime diskutohen në detaje gjendja e rekomandimeve dhe hapat që duhet ndërmarrë për implementimin e tyre.

### Çështja A5 - Zbatim i ulët i rekomandimeve të NJAB-së dhe mungesë e Planeve të Veprimit për rekomandimet e dhëna

#### Gjetja

Sipas Ligjit 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm, neni 5-pika 2.5 dhe neni 23-pika 1.3, Udhëheqësi i sektorit publik duhet të siguroj zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm, si dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për përmirësimin e sistemeve në pajtim me këto rekomandime. Ndërkaq, sipas Doracakut të Auditimit të Brendshëm, pjesa II, para finalizimit të Draft Raportit të Auditimit, Udhëheqësi i sektorit publik do të dorëzojë Planin e Veprimit për implementimin e rekomandimeve, duke ofruar të dhëna rreth planit për implementimin e tyre si dhe personave përgjegjës për të.

Në kuadër të MFPT-së, funksionojnë dy departamente të NJAB-së, ai i Thesarit dhe i Departamentit të Administratës Qendrore . Ne kemi trajtuar raportet e auditimit dhe rekomandimet e dhëna nga dy departamentet. NjAB kishte përfunduar 15 auditime me gjithsej 36 rekomandime të dhëna. Nga këto rekomandime, deri në fund të vitit vetëm një ishte zbatuar, kurse 35 ishin në proces. Më tutje, për këto auditime janë përgatitur Planet e Veprimit vetëm për tri raporte, kurse për pjesën tjetër AB nuk kishte mund të siguroj nga departamentet apo subjektet publike përgjegjëse për to.

Sipas zyrtarëve të MF-së, kjo ka ndodhur për arsye të mungesës së stafit për shkak të pandemisë COVID-19.

#### Ndikimi

Adresimi i dobët i rekomandimeve të NJAB-së nga ana e menaxhmentit mund të ndikoj në mos funksionimin e kontrolleve të brendshme. Po ashtu, mungesa e Planeve të Veprimit, mund të ndikoj në mos zbatimin e plotë të rekomandimeve dhe pa mundëson monitorimin e progresit të tyre.

#### Rekomandimi A5

Ministri duhet të ndërmerr masa për sigurimin e Planeve të Veprimit nga të gjitha njësitë administrative që u adresohen rekomandimet, si dhe të siguroj një përkushtim maksimal në përmirësimin në fushat ku dobësitë janë identifikuar, dhe rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë rishikimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, kemi identifikuar disa shpalosje jo të sakta në tabelat kryesore. Pas rekomandimeve të dhëna, Zyrtari Kryesor Administrativ në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor Financiar kishte korrigjuar PFV-të dhe shënimet janë të prezentuara sipas rregullores përkatëse.

#### Çështja 1

#### Mos prezentim i saktë i disa informatave në PFV

#### Gjetja

Lidhur me Raportin Vjetor Financiar të MF-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë në vijim:

**Neni 14- Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit (shënimi 9, të hyrat jo tatimore)**, në kolonën e realizimit është prezantuar vlera 2,291,000€, përderisa shuma e saktë e realizimit është 2,785,000€ (duke përfshirë shumën prej 494,000€ për të hyrat nga gjobat dhe licencimi).

**Neni 14- Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit (shënimi 12, të hyrat tjera tatimore)**, në kolonën e realizimit është prezantuar vlera 494,000€, kurse këto të hyra nuk janë të natyrës tatimore, por janë të hyra nga gjobat dhe licencat që realizohen në kuadër të MF-së. Prandaj, te ky shënim vlera duhet të jetë zero.

**Shënimet shpjeguese/Shënimi 8-** të hyrat total janë prezantuar në vlerë 1,515,616€, kurse do të duhej të ishte 1,517,274€. Kjo vlerë është paraqitur saktë në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit, mirëpo nuk përputhet me vlerën në shënimet shpjeguese.

#### Veprimi i kërkuar

Përgjegjësit për hartimin e PFV-ve të bëjnë korrigjimet e nevojshme në mënyrë që vlerat të jenë në përputhje me kërkesat e rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Rezultati

Zyrtari Kryesor Administrativ në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor Financiar kishte korrigjuar PFV-të sipas rekomandimeve të dhëna, dhe shënimet janë të prezentuara sipas rregullores përkatëse.

### 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Në këto shënime janë të përfshira edhe shpenzimet e realizuara nga DK dhe ATK. Ndërsa çështjet që i përkasin kësaj fushe (për DK dhe ATK) nuk ishin pjesë e këtij auditimi. Ato janë trajtuar në raporte të veçanta të auditimit. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>543,731,540.00</b>	<b>160,180,040.17</b>	<b>53,001,600.52</b>	<b>31,299,912.10</b>	<b>27,351,666.10</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	537,731,540.00	33,255,228.01	30,498,462.64	29,222,562.18	26,958,879.09
Financimi përmes huamarrjes	4,000,000.00	4,000,000.00	100,000.00	0.00	0.00
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0.00	38,300,000.00	21,410,000.00	0.00	0.00
Te hyrat nga AKP-ja	2,000,000.00	84,243,901.73	703,451.06	1,682,082.40	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	380,910.43	289,686.82	395,267.52	392,787.01

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 383,551,500 €. Ky zvogëlim është si rezultat i fuzionimit të programeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të MFPT-së (ish MF), si dhe programit për Rimëkëmbje Ekonomike për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Pas kthimit të programeve të MPMS në mandatin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (siç ka qenë në vitet e kaluara) dhe pas shpërndarjes së fondeve të Rimëkëmbjes në OB përkatëse, ka ndikuar që buxheti fillestar me atë final të kenë këtë zvogëlim të theksuar.

Në vitin 2020 MFPT ka shpenzuar 33% të buxhetit përfundimtar ose 53,001,311 €, me një ulje 35% në krahasim me vitin 2019. Zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>543,731,540.00</b>	<b>160,180,040.17</b>	<b>53,001,600.52</b>	<b>31,299,912.10</b>	<b>27,351,666.10</b>
Pagat dhe mëditjet	18,127,497.00	16,508,995.74	16,426,909.78	16,511,715.94	16,165,795.70
Mallrat dhe shërbimet	27,787,102.00	7,194,388.24	5,757,833.53	6,331,096.05	5,466,261.62
Komunalitë	738,642.00	304,498.04	256,017.54	287,193.72	306,571.07
Subvencionet dhe transferet	467,611,647.00	28,325,459.26	23,899,951.86	2,055,508.78	2,722,291.15
Investimet Kapitale	29,466,652.00	107,846,698.89	6,660,887.81	6,114,397.61	2,690,746.56

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve është 99.5%. Buxheti final ishte më i ulët për 1,618,500€ krahasuar me atë fillestar, si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe i Vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore;
- Buxheti final për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve (përfshirë komunalitë) ishte zvogëluar për 21,026,859€, ndërsa realizimi i tij ishte 80%. Ky zvogëlim i buxhetit ka ndodhë si arsye e largimit të programeve të ish MPMS-së nga MFPT (ish MF), si dhe për shkak të zvogëlimit të aktiviteteve dhe shpenzimeve normale si pasojë e situatës me pandemi. Arsyeja e njëjtë për pandemi është edhe për një realizim të tillë në këtë kategori;
- Buxheti i rishikuar me Ligjin e Buxhetit për kategorinë e Investimeve Kapitale ishte më i lartë se ai fillestar për 122,079,260€, kjo për arsye të planifikimit të programit për Rimëkëmbje Ekonomike. Mirëpo, nëse krahasojmë buxhetin final vërejmë një ulje nga buxheti me rishikim për 43,699,213€, për shkak të mos kalimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike në Kuvendin e Kosovës si dhe 4,000,000€ për Fondin në Mirëbesim për Kontigjencat Veriore, ku në buxhetin final nuk është e përfshirë. Në këtë kategori vërejmë një realizim të ulët të buxhetit, me vetëm 6.18%, për të njëjtën arsye të mos kalimit të Ligjit për Rimëkëmbje në Kuvendin e Kosovës; dhe
- Nëse analizojmë buxhetin fillestar me atë të rishikuar për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve, kemi një zvogëlim prej 262,529,457€, kjo për të njëjtën arsye me kthimin e programeve të MPMS-së nga MFPT ku pjesa më e madhe ka qenë e planifikuar për këto programe. Kurse buxheti final me atë të rishikuar është zvogëluar për 176,756,731€, kjo për shkak të mos realizimeve të një pjese të shpenzimeve për rimëkëmbje ekonomike të cilat realizohen përmes Vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit për këtë kategori është 84%.

Buxheti i MFPT-së për Covid-19 ishte 103,780,717€, prej tyre 99,433,335€ ishin për kategorinë e Investimeve Kapitale, dhe 4,347,382€ për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve. Nga kjo ishin shpenzuar gjithsej 21,513,499€ apo 21% e buxhetit final. Prej tyre 3,499€ janë nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve të cilat kishin të bënin me furnizime higjienike dhe medicinale, si dhe 21,510,000€ të cilat janë ndarë për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, përfshirë Doganën dhe ATK-në, për vitin 2020 ka realizuar të hyra neto prej 1,487,059,242€, ndërsa vetëm MFPT ka realizuar 493,043€. Këto të hyra kanë të bëjnë me gjobat ndaj institucioneve financiare dhe gjoba tjera, të hyrat nga licencimi i aktiviteteve individuale dhe të lira.

Çështjet që i përkasin të hyrave të grumbulluara nga DK dhe ATK nuk ishin pjesë e këtij auditimi. Ato janë trajtuar në raporte të veçanta të auditimit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Agjencitë / Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat neto 2020	Të hyrat neto 2019	Të hyrat neto 2018
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,520,058,139.23</b>	<b>- 32,999,425.04</b>	<b>1,487,058,714.19</b>	<b>1,638,550,252.12</b>	<b>385,270,768.36</b>
Administrata tatimore e Kosovës	467,039,832.84	- 31,344,053.96	435,695,778.88	460,562,065.58	424,739,809.24
Dogana e Kosovës	1,052,525,263.04	-1,655,371.08	1,050,869,891.96	1,177,799,214.02	- 39,613,730.61
Agjencioni Qendror i Prokurimit	1,200.00	0.00	1,200.00	0.00	0.00
Administrata Thesari i Kosovës	67,590.00	0.00	67,590.00	63,000.00	55,000.00
Administrata Qëndrore - MF	94,253.35	0.00	94,253.35	78,395.82	89,689.73
Njësia e Inteligjencës Financiare	330,000.00	0.00	330,000.00	47,576.70	0.00

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të MFPT ka rezultuar me katër rekomandime kryesore. MFPT kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, një rekomandim është zbatuar; një është në proces dhe dy janë të pa zbatuara (i mbyllur, i pazbatuar). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**





Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të siguroj se do të merren masa që brenda një periudhe të shkurtër kohore të sqarohet problemi me avanse dhe se të gjitha llogaritë e viteve paraprake të mbyllen.	Edhe pse menaxhmenti kishte ndërmarrë masa për t'a adresuar këtë çështje, ende mbetet si çështje e pa zbatuar në tërësi. Është formuar komisioni, për të cilin kishte arritur të zvogëlonte këto avanse, mirëpo nuk është arritur të arsyetohen të gjitha mjetet, prandaj paraqiten avanse të hapura.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se në bashkëpunim me OB-të përkatëse, të bëj identifikimin dhe vlerësimin e kërkesave për projektet që drejtohen në MF dhe ZKM, dhe bazuar në vlerësimin e bërë për këto projekte, ato të planifikohen në buxhetin e rregullt të organizatave përkatëse buxhetore. Gjithashtu, të sigurohet se mjetet nga rezervat, duhet të ndahen vetëm për raste të paparashikuara (urgjente), në pajtueshmëri me procedurat e kërkuara sipas LMFPP.	Gjatë auditimit të mostrave të këtij viti nuk kemi hasur në raste të tilla. Megjithatë për pagesat nga rekomandimi në fjalë, kjo çështje mbetet e mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Investimet kapitale	Ministri, duhet të siguroj që gjatë proceseve të prokurimit, Departamenti përkatës dhe personat tjerë të përfshirë në proces (komisioni i vlerësimit), të respektojnë në mënyrë të plotë kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë.	Gjatë auditimit të mostrave të këtij viti nuk kemi hasur në raste të tilla. Megjithatë për procedurën e prokurimit nga rekomandimi në fjalë, kjo çështje mbetet e mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Pasuritë	Ministri në bashkëpunim me menaxhmentin e NjIF-in duhet t'i rishikojnë kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si duhet dhe të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi.	Gjatë auditimit kemi verifikuar dhe kemi vërtetuar se pasuritë në fjalë janë evidentuar në regjistrin e pasurive.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që proceset e menaxhimit të pasurisë janë transparente dhe bëhen në përputhje të plotë me rregullën për menaxhimin e pasurive, duke harmonizuar gjendjen e pasurive me gjendjen e dalë nga inventarizimi.
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ri destinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.
3.	Të hyrat	Ministri duhet të siguroj se pas çdo mbyllje të periudhës mujore, zyrtarët përgjegjës bëjnë barazimin e të hyrave me Thesarin, të realizuara nga secili departament në kuadër të MF-së.
4.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të vazhdojë bashkëpunimin e mëtejshëm me Thesarin, me qëllim të eliminimit total të këtyre avanseve të hapura, si dhe të siguroj në të ardhmen mos përsëritjen e situatave të njëjta.
5.	Pasuritë	Ministri duhet të vazhdojë të bëjë kërkesë ndaj kompanisë përgjegjëse për sistemin e-pasuria dhe njëkohësisht të monitoroj nga afër funksionalizimin e këtij sistemi, në mënyrë që të sigurohet se pasuritë jo kapitale dhe stoqet regjistrohen dhe menaxhohen përmes këtij sistemi.
6.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të ndërmerr masa për sigurimin e Planeve të Veprimit nga të gjitha njësitë administrative që u adresohen rekomandimet, si dhe të siguroj një përkushtim maksimal në përmirësimin në fushat ku dobësitë janë identifikuar, dhe rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Fatlinda Ramosaj, Udhëheqëse e Auditimit



Edona Abazi, Udhëheqëse e ekipit



Blerim Kabashi, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije			
Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. i Org. Org. Jedin Org. Unit	01/401	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	1165/2021
Nr. i faqeve Bcei stranica No. pages		Data Datum Date	27.07.2021
Dokime PRISHTINE/A			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -*  
*Ministry of Finance, Labour and Transfers*

*Kabineti i Ministrimit - Kabinet Ministra - Minister's Cabinet*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Data: 27.07.2021, Prishtinë



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>7</sup> Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### *Forma e opinionit*

#### Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.